



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
GJEOGRAFI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

| | | | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|

SHKOLLA FILLORE

VENDI

KOMUNA


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 170620260845

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik dhe gomë, por nuk mund ta përdorësh kalkulatorin dhe telefonin mobil.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuar.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet (), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat të cilat kanë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

| SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR | |
|---|--|
| Tek detyra me një përgjigje të saktë | |
| Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë. | |
| <input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevc | |
| | |
| Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta | |
| Ngjyros rrathët para shprehjes, shuma e të cilës është 5. | |
| <input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5 | |

- Nëse e përfundon testin më herët se sa koha që është paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR
TESTI
GJEOGRAFI

1. Cila është shenja ndërkombëtare për lindjen?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ N ☐ S ☐ E ☐ W
2. Cilët forma të relievit janë të paraqitura në hartë me nijansat e ndryshme të ngjyrës së gjelbër?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ malet ☐ rrafshlartat ☐ ultësitrat ☐ shkretëtirat
3. Cili planet gjendet më së largu prej Diellit?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ Saturni ☐ Neptuni ☐ Jupiteri ☐ Urani
4. Si quhet procesi i lëvizjes së Tokës rreth Diellit?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ rotacioni ☐ akumulacioni ☐ revolucioni ☐ erozioni
5. Cilat janë sipërfaqet më të mëdha të ujit në Tokë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ oqeanet ☐ detet ☐ lumenjt ☐ liqenet
6. Si quhet numri mesatar i banorëve në një kilometër katror të territorit?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ dendësia e popullsisë ☐ shtimi natyror
- ☐ nataliteti ☐ mortaliteti
7. Cili kontinent ka pjesëmarrje më të madhe të popullsisë së re?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ Europa ☐ Afrika ☐ Amerika Veriore ☐ Australia
8. Cila veprimtari i takon sektorit terciar të ekonomisë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ shkenca ☐ pylltaria ☐ hotelieria ☐ ndërtimtaria

9. Në cilin kontinent gjendet shteti me më së shumti njerëz në botë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

☐ Amerikanoverior ☐ European ☐ Afrikan ☐ Aziatik

10. Në cilën hemisferë me gjithë sipërfaqen e saj gjendet Europa?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

☐ veriore ☐ jugore ☐ lindore ☐ perëndimore

11. Në cilin muaj në hemisferën veriore të Tokës paraqitet dita e shkurtë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

☐ janar ☐ qershor ☐ shtator ☐ dhjetor


12. Ngjyros rrethin në fushën e duhur për të lidhur tipet e liqeneve me mënyrën e krijimit të basenit të tij.

| | tektonike | krasike | eolike |
|--|-----------------------|-----------------------|-----------------------|
| Krijohen kur uji mbush thellimet në hapësirën gëlqerore. | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Krijohen kur uji mbush pjesët e tokës të lëshuara pranë shkëputjeve. | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Gjenden në thellimet e krijuara me punën e erës. | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |

13. Cili nga shtetet e përmendura nuk është anëtar i unionit European?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

☐ Bullgaria
☐ Belgjika
☐ Zvicrra
☐ Spanja

14. Cilat janë karakteristikat e moshë-gjinisë të paraqitura në fotografi në piramidën për Serbinë?



Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ pjesëmarrje më e lartë e popullsisë në raport me të rinjtë
- ☐ pjesëmarrje më e madhe e popullsisë me moshë 30–34 vjeçe
- ☐ pjesëmarrje më e madhe e popullsisë së re
- ☐ pjesëmarrje më e vogël e grave në raport me meshkujt të moshës 80–84 vjeçe

15. Cili lum e ka prerë grykën e Ovçar-Kabllarit?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.


- ☐ Morava e Madhe
- ☐ Morava Jugore
- ☐ Morava Perëndimore
- ☐ Morava e Binçës

16. Cila pjesë e Azisë ka bregdetin më të përthyer?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ Azia Jugperëndimore
- ☐ Azia Qendrore
- ☐ Azia Jugore
- ☐ Azia Juglindore

17. Në cilin oqean gjendet pika me koordinatat 30° GJGJV dhe 30° GJGP?



Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ Ngrirë të Veriut ☐ Atlantik ☐ Indian ☐ Qetë

18. Je në vizitë të manifestimit „Ditët e Jovan Cvijiqit” në Lloznicë. Deri tek cila banjë më e afërt mund të bësh pushim? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ banja Vrdnik ☐ banja Koviljača ☐ Sokobanja ☐ Vrnjačka banja

19. Cilat shtetet me një pjesë gjenden në ultësirën e Panonisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ Greqia ☐ Bullgaria ☐ Kroacia ☐ Shqipëria ☐ Sllovenia

20. Është lumi më i gjatë i Angloamerikës. Bashkohet me Misurin tek qyteti Shën Luis. Rrjedh në drejtim të meridianit përmes ultësirës Qendrore. Para grykëderdhjes në gjirin e Meksikës formon deltën e madhe. Cili është ky lum?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ Misisipi ☐ Mekenzi ☐ Mekongu ☐ Murray

FAQE E ZBRAZËT



Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI

GJEOGRAFI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

| | | | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|

SHKOLLA FILLORE
VENDI
KOMUNA

| | | | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR